

Analizë e Situatës dhe Identifikimi i Nevojave

Për Ndryshime Ligjore në Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Llogaridhënies në Administratën Tatimore të Kosovës

Prishtinë, Dhjetor 2018



British Embassy
Prishtina



DEMOCRACYPLUS

Analizë e Situatës dhe Identifikimi i Nevojave

Për Ndryshime Ligjore në Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Llogaridhënies në Administratën Tatimore të Kosovës

Prishtinë, Dhjetor 2018

Përmbajtja

Legjislacioni	04
1. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës	
<i><u>a. Mungesa e rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë hetimin administrativ</u></i>	05
<i><u>b. Rotacioni i shërbyesve civil</u></i>	
<i><u>c. Transferet</u></i>	06
<i><u>d. Statusi i shërbyesit civil për inspektorët tatimor</u></i>	07
<i><u>e. Verifikimi i integritetit të zyrtarit</u></i>	
<i><u>f. Afatet e shkurtra për marrje të vendimeve të këshillit disiplinor</u></i>	
2. Ligji për Administratën Tatimore të Kosovës	08
<i><u>a. Deklarimi i pasurisë</u></i>	
<i><u>b. Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor</u></i>	09
<i><u>c. Dërgimi i rasteve drejtpërdrejt në Komision Disiplinor nga Zyra e Standardeve</u></i>	
Rekomandime	10

Hyrje

Ky dokument ka për qëllim analizimin e legjislacionit aktual që rregullon funksionimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), duke u ndalur në çështjet e rekrutimit dhe menaxhimit të resurseve njerëzore me qëllim të parandalimit të korrupsionit dhe sjelljeve joetike të punonjësve të ATK-së. Përmes kësaj analize identifikohen problemet në legjislacion duke përfshirë jo vetëm Ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës (me plotësimet dhe ndryshimet) por edhe ligjet e tjera të cilat e ndikojnë punën e ATK-së, ku kryesisht përfshihet Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Analizimi i këtyre ligjeve do të krahasohet me të dhënat e mbledhura nëpërmjet intervistave, vendimeve të nxjerra nga ATK dhe institucionet mbikëqyrëse. Kjo do të bëhet për të nxjerr përfundime në lidhje me problemet eventuale ligjore me të cilat ballafaqohet ATK në luftimin e konfliktit të interesit, korrupsionit të brendshëm dhe deklarimit të pasurisë. Në kuadër të kësaj analize do të përfshihen edhe aktet nënligjore, të tilla që rregullojnë statusin e punëtorëve në ATK apo rregullojnë procedurat e rekrutimit dhe menaxhimit me burime njerëzore.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve, ekipi ligjor i BIRN-it dhe D+ do të propozojnë për sponsoruesin e ligjeve, amendamente të cilat do të përfshihen në fazë të plotësim-ndryshimit të ligjeve. Kjo me qëllim që procesi i luftimit të korrupsionit, konfliktit të interesit, deklarimit të rremë të pasurisë, të lehtësohet për ATK-në. Qëllim tjetër i analizës është të ofrojë argumente në lidhje me nevojën e publikimit të formularëve për deklarim të pasurisë, të cilat do t'u ndihmonin palëve të denoncojnë rastet e deklarimit të rremë të pasurisë.

Të dhënat për hartimin e kësaj analize janë mbledhur përmes hulumtimit të të dhënave të qasshme online (ligje, udhëzime, rregullore, raporte dhe artikujtë në media), intervistave direkte me zyrtarë të ATK-së, palë të treta, pyetësorin e vetëvlerësimit të dërguar Zyrës së Standardeve në ATK dhe intervistës me Dogana dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.

Legjislacioni

Puna e Administratës Tatimore të Kosovës rregullohet kryesisht me dy ligje të cilat e ndikojnë raportin e saj me të punësuarit. Këto dy ligje përfshijnë Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Administratën Tatimore. Këto ligje, përveç të tjerash, rregullojnë formën e rekrutimit, mbikëqyrjes, transferimit dhe hetimit të zyrtarëve publikë, të cilët kanë statusin e shërbyesit civil. Ligji për Administratën Tatimore më tutje specifikon obligimet dhe të drejtat e ATK-së për përgjegjësi shtesë ndaj zyrtarëve të saj. Ky Ligj vë theksin te inspektorët tatimorë dhe organet mbikëqyrëse të cilat garantojnë integritetin institucional.

Për shkak të pushtetit të madh diskrecional që kanë inspektorët e ATK-së në raport me bizneset, krijohet rreziku që inspektorët të përfshihen në vepra të korrupsionit me qëllim të përfitimit për vete apo anëtarët e afërm të familjes. Kjo ndodh kryesisht në kuadër të kontrollit, vizitave dhe shqiptimit të gjobave që u bëjnë bizneseve, por në disa raste edhe ofrimin e pëlqimeve apo licencave për operim, si në rastin e lojërave të fatit (bastoret dhe kazinot).

Për të parandaluar këtë gjë, me legjislacion janë krijuar mekanizma mbikëqyrës, të cilët jo vetëm se përcjellin në nivel administrativ rastet e mundshme të korrupsionit për t'i denoncuar ato në institucionet ndjekëse, por edhe angazhohen në masa parandaluese. Sidoqoftë, përveç këtij rreziku që inspektorët të përfshihen në vepra të korrupsionit, ekziston edhe rreziku i dytë, që të njëjtit të jenë target i ndikimit, dhunës, shtrëngimit apo kërcënimeve për të kryer punën në një apo mënyrën tjetër.

Duke tentuar të balancohet në mes të këtyre dy interesave publike Ligji për Shërbimin Civil dhe ai për Administratën Tatimore të Kosovës, kanë paraparë jo vetëm institucionet hetuese por edhe ato mbrojtëse. Këto institucione garantojnë se të drejtat e inspektorëve nuk do të shkelen nga menaxhmenti apo palët e treta.

Nëpërmes analizimit të legjislacionit do të vihet dritë mbi problemet të cilat janë hasur në praktikë për shkak të mangësive ligjore, apo interpretimeve të gabuara të ligjit nga institucionet në nivele të ndryshme. Për më tepër analiza vë theksin te mungesat e udhëzimeve dhe rregulloreve administrative të cilat është dashur të plotësojnë legjislacionin primar.

1. Ligji për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës

Me këtë Ligj janë vënë bazat e të gjithë administratës publike në Republikën e Kosovës. Ligji ka për qëllim që të ruajë administratën dhe veçanërisht shërbimin civilë nga ndikimi politik apo ndonjë ndikim tjetër për të garantuar vazhdimësi dhe mekanizma të shumtë mbrojtës për shërbyesit civilë. Sidoqoftë, këta mekanizma ndonjëherë shndërrohen në strehë për zyrtarët të cilët shkelen ligjin, për shkak të standardit të lartë mbrojtës dhe pamundësisë së institucioneve për të adoptuar masa mbrojtëse proporcionale. Edhe më e ndjeshme është situata në rastet kur institucionet tentojnë të hartojnë politika për të parandaluar konfliktin e interesit qoftë ai real apo në dukje, dhe të cilat

ndonjëherë nuk mund të zbatohen për shkak të Ligjit për Shërbimin Civil, i cili parasheh shumë mekanizma mbrojtës për zyrtarët. I tillë është rasti me ATK-në, e cila shprehet e paaftë që me sukses të parandalojë dhe luftojë dukuritë negative brenda saj, për arsye të ligjeve të papërshtatshme dhe interpretimeve të gabuara të Ligjit nga Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil (KPMShC).

a. Mungesa e rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë hetimin administrativ

Megjithëse Ligji për Shërbimin Civil është aprovuar në vitin 2010, pjesa e hetimit administrativ asnjëherë nuk është rregulluar me akte nënligjore të cilat do t'u ofronin mundësi institucioneve të hetojnë zyrtarët e tyre. Kjo ka ndikuar që politikat e brendshme të institucioneve në shumë raste të mos merren parasysh nga KPMShC. Prandaj çështja e hetimit administrativ e rregulluar me nenin 79 të këtij Ligji, ka nevojë që më tutje të sqarohet përmes akteve nënligjore. Kjo mund të bëhet nga një udhëzim administrativ i veçantë apo rregullore të ministrive, sipas nevojave dhe specifikave të brendshme.

b. Rotacioni i shërbyesve civilë

Në mënyrë që të shmangët krijimi i lidhjeve në mes të inspektorëve dhe bizneseve, ATK e ka vlerësuar si të nevojshme krijimin e një sistemi të rotacionit, ku një inspektor i ATK-së nuk do të inspektonte të njëjtat biznese apo të njëjtin regjion për një kohë më të gjatë sesa gjashtë muaj apo një vit. Kjo do të ndihmonte që zyrtarët të transferohen në pozita të ndryshme sipas nevojës së përcaktuar me politika të brendshme të institucionit. Aktualisht, sipas Zyrës së Standardeve dhe drejtuesve të ATK-së, kjo gjë nuk është e mundur, pasi që Ligji për Shërbimin Civil e garanton shërbyesin civil në vendin e tij të punës. Për më tepër, transferet mund të bëhen në raste shumë të kufizuara dhe në pozita ekuivalente. Madje, edhe këto pozita ekuivalente ndonjëherë nuk mund të bëhen pasi që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i kthen zyrtarët në vendet e tyre paraprake. Për shembull, KPMShC në rastin *Rexhep Çoçaj v. Administrata Tatimore e Kosovës*, 5849/2018, kundër të cilit ishte dhënë masa e transferit, KPMShC e ka kthyer lëndën në rishqyrtim lëndën për shkak se transferi ishte bërë pa përcaktuar afatin kohor. Sipas Ligjit dhe Rregullores, për të transferuar një zyrtar të lartë pa pëlqimin e tij, mund të bëhet vetëm për gjashtë muaj maksimalisht¹.

Shqetësuese për drejtuesit e ATK-së mbetet rasti i zyrtarëve të cilët merren me tatimpagues të mëdhenj dhe veçanërisht ata që merren me lojëra të fatit. Në këto dy raste rotacioni do të ishte tejet i nevojshëm, sipas ATK-së, për të bërë të pamundur krijimin e lidhjeve klienteliste apo shoqërore në mes të zyrtarëve dhe këtyre bizneseve. Të hyrat e larta që inkasojnë nga këto biznese dhe detyrimet e larta tatimore, janë një motivim për të gjetur forma të mos pagesës së obligimeve të plota tatimore. Zyrtarët e ATK-së kanë dyshime se në praktikë ndodhin raste ku kemi shmangie tatimore me marrëveshje në mes të inspektorëve dhe bizneseve sidomos tek lojërat e fatit. Për shkak se të dy palët në këtë rast përfitojnë, dhe mbeten "të kënaqur" dhe vetëm buxheti i Kosovës

¹ Neni 16 Ligji për Shërbimin Civil: Zyrtarët e lartë drejtues dhe zyrtarët drejtues në shërbimin civil, mund të caktohen në pozita të ndryshme me gradë ekuivalente për një periudhë të caktuar kohore, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

është i dëmtuar. Për shkak të natyrës specifike të krimit, këto raste shumë pak raportohen nga ndonjë dëshmitar. Hetimi dhe gjykimi i rasteve është, po ashtu, shumë i vështirë për t'u dëshmuar. Rrjedhimisht, masa parandaluese e rotacionit konsiderohet se do të mund të zbuste këtë problematikë.

ATK ka të hapur një linjë të raportimit, e cila dërgon gjithmonë tek Zyra e Standardeve Profesionale. Kjo në vete është problematike pasi që jo çdo informatë është për mandatin e kësaj Zyre. Çështjet si evazioni fiskal, marrja e informatave të ndryshme nga qytetarët dhe të tjera do të duhej të adresoheshin në zyrat përkatëse. Për më tepër, nëse një rast është lajmëruar në këtë Zyre, nuk ka asnjë garanci se janë marrë shënimet e duhura dhe se procedura është iniciuar. Prandaj, do të ishte mirë që të ndërtohet një sistem elektronik i regjistrimit të informatave, duke përfshirë telefonatat, e-mail-et dhe për aq sa është e mundur format të tjera të raportimit të informatave për të garantuar se punonjësit nuk fshehin ndonjë informatë për të mbrojtur ndonjë palë. Ky problem edhe pse në dukje teorik, pasi që aktualisht nuk ka ndonjë pretendim se diçka e tillë ka ndodhur, mirëpo aplikimi i masave të tilla të regjistrimit do të shtonin besimin në punën e kësaj Zyre.

Zyra për Standarde e ATK-së nuk plotëson kushtet e punës dhe ruajtjes së fshehtësisë së procedurës. Aktualisht ky entitet ka një zyrë brenda ndërtesës së ATK-së. Përveç se hapësira është e ngushtë dhe e pamjaftueshme për të zhvilluar një procedurë normale, ajo është edhe e ekspozuar ndaj pjesës tjetër të stafit të ATK-së. Për të shkuar në këtë Zyrë palët duhet të lajmërohen tek sigurimi i objektit, legjitimohen nga këta të fundit, ngjihen në katin e pestë dhe pastaj të shkojnë tek një zyrë e vogël, në të cilën ndodhen të katër punonjësit e kësaj Zyre. Edhe pse palët mund të kërkojnë të mos shënohen në librin e vizitorëve, prapëseprapë ata i ekspozohen zbulimit nga pjesa tjetër e stafit të ATK-së. Procedura zhvillohet në prani të katër punonjësve brenda zyrës në mungesë të hapësirave. Kjo shton mundësinë e rrjedhjes së informatave dhe për më tepër vështirëson gjetjen e personave të cilët potencialisht kanë mundur të nxjerrin informacione jashtë pa autorizime. Për më tepër, palët mund të shihen duke hyrë dhe duke dalë nga zyrat dhe potencialisht edhe të dëgjohen deklaratat e tyre, pasi që zyra nuk ka ndonjë mbrojtje akustike. Po ashtu, punonjësit e kësaj Zyre nuk kanë dhoma të marrjes së deklaratave apo dëshmimeve, nga palët në procedurë dhe mbajtja e informatave të fshehta është tejet e cenueshme në këtë infrastrukturë.

c. Transferet

Përveç se rotacionet nuk janë të lejuara me Ligjin për Shërbimin Civil, transferimi i zyrtarëve është po ashtu i vështirë. Transferimi (pa pëlqimin e palës) sipas nenit 28 të Ligjit, mund të jetë i përkohshëm për disa raste, ndërsa ai i përhershëm mund të bëhet vetëm në pozita ekuivalente dhe në marrëveshje me zyrtarin. Për më tepër, Ligji kërkon që kushtet e punësimit të mos jenë më të pafavorshme se ato që i ka pasur në vendin e punës. Kjo dispozitë ndikon që shërbyesit civilë të kundërshtojnë secilin transferim me arsyetimin se vendi i tyre i ri i punës ka kushte më të pafavorshme. Sipas kësaj logjike, zyrtarët e ATK-së thonë se janë fituar raste në KPMSHC kundër ATK-së.

Shembull: Një inspektor i nivelit të tatimpaguesve të mëdhenj të regjionit X nuk mund të transferohet në një regjion tjetër pa pëlqim. Ose edhe rastet ku inspektorët e tatimpaguesve të mëdhenj transferohen në tatimpagues të vegjël, KPMSHC i kthen në pozitat e tyre për shkak të shkëlqes së Ligjit të Shërbimit Civil.

d. Statusi i shërbyesit civil për inspektorët tatimorë

Ndër çështjet e identifikuar si problematike dhe të cilën e kanë adresuar gjatë gjithë kohës drejtuesit e ATK-së është statusi i shërbyesit civil për inspektorët tatimorë. Ky status garanton mbrojtje shumë të gjerë për zyrtarët dhe ATK në shumë raste është e paaftë që të bëjë politika të brendshme të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit për shkak të kësaj arsyeje. Edhe në ato raste kur masat anti-korrupsion mund të aplikohen, në shumicën e rasteve ATK dështon që të ndjekë në përgjegjësi zyrtarët, kryesisht për shkak se masat bien ndesh me legjislacionin për shërbimin civil. ATK kërkon që çështja e inspektorëve tatimorë të rregullohet me rregulla të brendshme, ngjashëm me Doganën dhe Policinë e Kosovës, të cilat këto çështje i rregullojnë me dokumente të veçanta. Pjesa tjetër e stafit të ATK-së mund të trajtohet sipas dispozitave të Ligjit të Shërbimit Civil. Sqarimet e dhëna nga ATK për mospërfshirjen e inspektorëve në kuadër të këtij shërbimi janë të qëndrueshme për shkak të natyrës së punës së inspektorëve dhe nivelit të rrezikut për përfshirje në korrupsion.

e. Verifikimi i integritetit të zyrtarit

Ligji për Shërbimin Civil ka paraparë se vetëm personat për të cilët është shqiptuar dënim me burg efektiv me vendim të formës së prerë të gjykatës për një periudhë më të gjatë sesa gjashtë muaj largohen nga puna. Veprat e tjera të cilat janë të dënueshme por më pak se gjashtë muaj nuk dërgojnë në largime automatike nga vendi i punës sado që ato mund t'i bëjnë zyrtarët të papërshtatshëm për të vazhduar në kryerjen e punës së tyre.

Për të gjitha këto raste, Komisioni Disiplinor shqyrton nëse të njëjtat duhet shoqëruar me masa administrative apo disiplinore mirëpo nuk ka për detyrim ta bëjë këtë. Kjo është veçanërisht problematike në rastet e korrupsionit, pasi që politikat ndëshkimore në Kosovë janë të tilla, ku këto vepra dënohen minimalisht apo edhe me dënime me kusht. Nuk ekzistojnë mjetet ligjore për të bërë verifikimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë në vendet e tyre të punës, përmes të cilave do të determinohej nëse zyrtarët duhet të vazhdojnë apo jo kryerjen e punës së tyre.

f. Afatet e shkurtra për marrje të vendimeve të Këshillit Disiplinor

Nga fillimi i një procedure disiplinore deri në marrjen e vendimit nga Komisioni Disiplinor në ATK nuk mund të kalojnë më shumë sesa 30 ditë. Në këto raste, Këshilli mund të autorizojë Zyrën për Standarde në asistimin e saj për të mbledhur provat e nevojshme për trajtimin e rasteve, por afati prej 30 ditësh nuk mundëson çdo herë efikasitet në gjetjen dhe shqyrtimin e të gjitha provave. Si pasojë e kësaj, zyrtarët e ATK-së kanë tërhequr vërejtjen se në shumë raste mund të ndodhë që inspektorët t'u shpëtojnë ndëshkimeve. Afati i hetimit administrativ duhet të zgjatet të paktën për aq sa zgjatë procedura administrative e zakonshme 45-90 ditë.

2. Ligji për Administratën Tatimore të Kosovës

Problemet me Ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës lidhen ngushtë me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil. Për shkak se Ligji për Shërbimin Civil ka rregulluar shumicën e çështjeve që lidhen me të drejtat dhe përgjegjësitë e shërbyesve civilë, Ligji për ATK është i kufizuar për të rregulluar çështjet e ATK-së sipas nevojave të brendshme institucionale. Zyrtarët e ATK-së në shumicën e rasteve për këtë çështje fajësojnë KPMSHC-në.

a. Deklarimi i pasurisë

Ligji për ATK-së ka paraparë çështjen e deklarimit të pasurisë nga punëtorët e këtij institucioni. Mosdeklarimi apo deklarimi i rremë sipas këtij Ligji çon në ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në Ligj nuk përcaktohen cilët janë ata punonjës të cilët obligohen të bëjnë deklarimin apo në çfarë afate kohore dhe as nuk përcakton forma të verifikimit të saj. Ligji përmend te neni 3.9 këtë çështje por pa e zbrërthyer apo pajisur me mandat Zyrën e Standardeve që të bëjë verifikimet e nevojshme. Problem me deklarimin e pasurisë është se ai kërkohet vetëm për të punësuarit dhe nuk përfshin familjarët e tyre. Kjo u mundëson personave që të bëjnë bartjen e pasurisë te një nga anëtarët e familjes për t'i ikur deklarimit.

Për ATK-në, mosdeklarimi i pasurisë dhe/apo deklarimi i rremë nuk përbën vepër penale. Ai vetëm është bazë që në përputhje me Ligjin për ATK-në të ndërpritet marrëdhënia e punës. Në anën tjetër, kjo mund të bie në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil, i cili ka përcaktuar veprën penale të dënueshme me gjashtë muaj burgim efektiv për largimin e shërbyesve civilë. Për më tepër, Kodi Penal në nenin 437.2 parasheh: *Çdo person, i cili sipas Ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

Sipas këtij definimi të Kodit Penal edhe ky lloj deklarimi, i paraparë me Ligjin për ATK-në, do të duhej të përbente vepër penale nëse bëhet në kundërshtim me dispozitat e tij. Në ATK thonë se përkundër dyshimeve për shumë inspektorë, ata janë të paaftë të bëjnë kontrollin e deklaratave të pasurisë së tyre për shkak të mungesës së mandatit dhe mekanizmave zbatues. Sidoqoftë, Zyra e Standardeve bën disa verifikime të këtyre deklaratave përmes regjistrimit të automjeteve, tatimit në pronë, të ardhurat në ATK, mirëpo edhe ATK pranon se ky verifikim nuk është i plotë dhe se ka mangësi për shkak të mungesës së një mandati të qartë ligjor. Në anën tjetër, Agjencia Kundër Korrupsionit ka mandat të plotë të bëjë këtë dhe Zyra e Standardeve do të duhej ose të kërkonte ndihmën e AKK-së, ose të pajiset me mandat për të bërë vetë këtë verifikim.

Ky deklarim nuk është publik dhe personat e tretë nuk kanë mundësi të shohin pasurinë e këtyre zyrtarëve dhe nëse vërejnë shpërputhje të lajmërojnë atë tek organet përkatëse. Në këtë formë ATK mbron privatësinë e inspektorëve por ekspozon institucionin përballë mashtrimit dhe deklarimit të rremë.

ATK arsyeton se me Komentarin e Kodit Penal vetëm deklarimi në Agjencinë Kundër Korrupsion njihet si vepër penale, asnjë deklarim tjetër nuk trajtohet si i tillë. Për më tepër, ATK thotë se ka denoncuar në Polici dhe Prokurori raste të tilla të mosdeklarimit të pasurisë apo deklarimit të rrejshëm, por se të njëjtat nuk janë trajtuar si vepra penale nga këto institucione.

b. Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor

Sado e pakënaqur që Zyra e Standardeve mund të mbetet me masat që merr Komisioni Disiplinor, ajo nuk ka të drejtë ankesë ndaj vendimeve të këtij Komisioni dhe as në rastet e Komisionit të Ankesave. Kjo çështje ndikon që edhe në ato raste kur potencialisht Komisioni merr vendim të gabuar në favor të palës, të mos ketë mekanizëm që lejon përmirësimin e këtyre gabimeve. Pretendimet e Zyrës së Standardeve për vendime të gabuara të Komisionit Disiplinor apo atij të ankesave do të duhej të trajtoheshin nga një instancë e dytë.

c. Dërgimi i rasteve drejtpërdrejt në Komision Disiplinor nga Zyra e Standardeve

Zyra e Standardeve nuk mund të dërgojë rastet drejtpërdrejt në Komision Disiplinor. Madje, sipas Zyrës së Standardeve në vitin 2015 KPMSHC ka anuluar tri vendime të ATK-së, pasi që sipas këtij institucioni këto veprime mund të merren nga udhëheqësi drejtues apo udhëheqësi më i lartë administrativ. Kjo përbën një kufizim, pasi që çdo rast duhet të dërgohet përmes drejtorit të ATK-së. Në këto raste, nëse drejtori nuk ka vullnetin e nevojshëm për të përcjellë rastin në Komision Disiplinor këta inspektorë mund të mbesin të pandëshkuar. Edhe pse një rast i tillë nuk raportohet të ketë ndodhur deri më tani, kjo të paktën në teori lë një mundësi që drejtori të shmangë rekomandimin e Zyrës së Standardeve. Po ashtu, pikëpyetje mbetet adresimi i shkeljeve të kryera nga vetë drejtori, të cilat mund të jenë shkelje e etikës apo të ngjashme. Në këto raste, Zyra e Standardeve do të ishte e pafuqishme për të trajtuar këto çështje.

Rekomandime

Për të garantuar një integritet më të lartë dhe mekanizma efikasë në kuadër të ATK-së për luftimin me sukses të shkeljeve të ligjit dhe kodit etik, një varg ndryshimesh rekomandohet të bëhen në legjislacion. Ndër çështjet kryesore të cilat duhet të adresohen janë:

Drejtori i ATK-së të iniciojë deklarinin e pasurisë në baza vjetore - Deklarimi i pasurisë të jetë i domosdoshëm të paktën një herë në vit për të gjithë punonjësit e ATK-së. I njëjti të jetë në dispozicion të publikut për të pasur mundësinë e denoncimit të rasteve të deklarinimit të rremë të pasurisë. Ky deklarinim të bëhet përmes një platforme elektronike online, e cila po ashtu mundëson përditësimet në rast të ndryshimeve në gjendjen e pasurisë së zyrtarëve. Deklarimi i pasurisë të bëhet edhe për anëtarët e familjes së zyrtarëve dhe jo vetëm për zyrtarin.

Statusi i inspektorëve tatimorë - Inspektorët tatimorë të përjashtohen nga Ligji i Shërbimit Civil apo të parashihen si një kategori e veçantë dhe për këtë arsye të trajtohen si kategori e ndarë e punonjësve në mënyrë që të mund të merren masa shtesë për të parandaluar veprimet e tyre të cilat konsiderohen si konflikt i interesit apo shkelje të tjera të ligjit dhe kodit të etikës. Kjo do të t'i mundësonte ATK-së që të: 1. Krijonte procedura disiplinore sipas nevojave të saj, 2. Adoptimin e rregullores për rotacionin e stafit mbi baza të rregullta kohore dhe në ato raste kur ka dyshime se janë ulur paarsyeshëm të hyrat në entitete të caktuara, 3. Mosdeklarimi i pasurisë përveç denoncimit në Polici dhe Prokurori të dërgonte në shkëputje të marrëdhënies së punës në formë automatike, 4. Të krijoheshin mekanizmat e brendshëm për verifikimin e integritetit, 5. Vendimet e ATK-së t'i nënshtrohen vetëm kontrollit gjyqësor dhe jo KPMSHC-së.

Krijimi i legjislacionit për hetim administrativ - ATK përmes Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Kosovës të iniciojë krijimin e legjislacionit për hetim administrativ, i cili i jep mandatin e nevojshëm asaj të bëjë kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të saj, hetimin e veprimeve të kundërligjshme të zyrtarëve të ATK-së dhe shqiptimin e masave të nevojshme për shkeljet e evidentuara. Rastet e trajtuara nga ATK të jenë vetëm objekt i rishqyrtimit gjyqësor, jo edhe i shkallës administrative. Kjo do të ndihmonte në trajtimin më të shpejtë dhe më efikas të rasteve.

Rotacion i pozitave të inspektorëve - Pozitat e inspektorëve tatimorë të jenë të përkohshme dhe në baza vjetore inspektorët ta ndërrojnë terrenin dhe llojin e bizneseve të cilat i mbikëqyrin për të shmangur krijimin e raporteve me tatimpaguesit. Këto pozita të jenë të përkohshme duke u zëvendësuar sipas rotacionit të rastësishëm të përcaktuar me një aplikacion apo short.

Përgatitur nga Demokraci Plus (D+) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese në Kosovë (BIRN), Ambasada Britanike në Prishtinë ka mbështetur përgatitjen e këtij publikimi, në kuadër të projektit “Mbështetja e shoqërisë civile mbi rritjen e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së institucioneve publike të Kosovës”. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.